

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Blerje Gazoil D1”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 09134100-8, 09100000-0, 24321000-0

Vlera e fondit limit: 29 926 600 (njëzet e nëntë milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind) Lekë, pa TVSH

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Dimal, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2.KRITERET E VECANATA TE KUALIFIKIMIT

1.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar.

- Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim”

-Nenin 82 “Formulari përmbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës I vetëdeklarimit dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

2.Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.Kapaciteti ligjor/professional i operatorëve ekonomike:

Sipas kriterëve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit të 2019, 2020, 2021 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public", I ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave. në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Ofertuesiduhet të tregojë se teknikisht është në gjendje të realizojë qëllimin e prokurimit.Për të provuar mundësinë e tij teknike për këtë prokurim, ofertuesi duhet të paraqesë, kontratat e furnizimit të mallrave të ngjashme, me vlerë jo më të vogël se 50% të fondit limit të tre viteve të fundit.

PËR të vërtetuar pikën e mësipërme Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Enti Publik që ka lidhur kontratën, për ekzekutimin e kontratës pa të meta, kontratën me entin public si dhe faturën tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77"Kërkesat per kualifikim", te Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" pika 4.. "ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojnë se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene një nivel të mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren" dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë

në një vlerë jo më madhe se 50% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.2.3 Vërtetimin nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të vitit 2019, 2020, 2021, të jetë 40% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. i ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar soperatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushume sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj furnizimes në tregun shqiptar, sasinë dhe cilësinë e mallit objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertuesit paraqesë dokumenta se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Përkontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave.

2.2.4 Formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje); Ofertuesi në këtë formular, do të shprehë marzhin e fitimit, në vlerën absolute dhe përqindje; Ofertuesi në system do të ofertojë me vlerën totale të përlogaritur sipas cmimit të bursës, kursin e bankës së shqipërisë dhe taksat e tjera sipas ligjit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 45, dhe 107, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, I ndryshuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme, që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport analizimi të cilësisë së karburantit që kerkohet, leshuar nga Inspektoriati Shtetëror I Kontrollit të naftës, gazit dhe nenprodukteve të tyre në Republikën e Shqipërisë brenda vitit 2021.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nenprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel” pasi AK kërkon të garantohet që karakteristikat teknike të mallit të ofertuar të përputhen me standartet teknike të kërkuara nga AK.

2.3.2 Operatori elektronik duhet të jetë i pajisur me Akt Teknik të leshuar nga PMNZH dhe Police Sigurimi leshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri.

2.3.3 Operatori elektronik duhet të deklarojë (me vetedeklarim) se mer persiper furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbime 24 ore.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi një pikë karburanti nën juridiksionin e Bashkisë Ura Vajgurore.

2.3.5 Leje për tregëtim të karburantit të leshuar nga Njesitë e Qeverisjes Vendore.

2.3.6 Operatori duhet të ketë të paktën një vendndodhje të ushtrimit të aktivitetit brenda juridiksionit të Bashkisë Dimal.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë vërtetim teknik të leshuar nga IQT për depozitat me kapacitet jo më pak se 85000 litra.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë kalibrimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit për depozitat.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë pasur mesatarisht jo më pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Janar 2022-Tetor 2022. Për të vërtetuar këtë, ofertuesi të paraqesë vërtetim nga organet tatimore për periudhën e mësipërme si dhe listë pagesat.

2.3.10 Ofertuesi të sigurojë furnizimin edhe në rastet e emergjencave për karburante gjatë punimeve për eliminimin e avarive në vende që ndodhen larg pikave të furnizimit. Për këtë qëllim ofertuesi duhet të ketë mjet të posaçëm (autobot) të kalibruar, jo më pak se 5000 litra, të pajisur me aparat matës (debitmatës) dhe të licensuar me certifikat për transport mallrash të rrezikshme.

2.3.11 Operatori duhet të jetë i pajisur në leje mjedisi Kodi III.1.B me përkrahje veprimtarie Leje mjedisi tipi B. Furnizim me karburante I makinave në një stacion të furnizimit me

karburant ne zonat urbane. Per plotesimin e ketij karakteri te paraqitet leja e mjedisit kodi III.1B.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te dorezoje kopjen e certifikates se pronesise per sheshin, si dhe formularin per lidhjen e objektit me infrastrukturen.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet te kete certifikaten e perdorimit/shfrytezimit te objektit, te leshuar nga institucionet perkatese, sipas legjislacionit ne fuqi per planifikimin e territorit.

2.3.14 Operatori ekonomik duhet te kete vertetimin e kontrollit e objektit, per respektimin e kushteve teknik, te leshuar nga Inspektoriati Shteteror Pergjegjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nennt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, *I ndryshuar*.

Këto kriteret janë vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, Urdhër Nr. 6, datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse, Urdhërit nr 315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj”, Ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “për Lejet e Mjedisit”, të ndryshuar.

2.3.15 Operatori ekonomik duhet të paraqesi, projektin teknik të kryqëzimit të rrugës me hyrje-daljen ku të jenë të përcaktuar të gjitha hyrje-daljet ekzistuese të kësaj zone, në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.10488 datë 5.12.2011 ‘‘Hyrje dhe Degëzime’’ dhe VKM nr.153 datë 7.4.2000 dhe gjithashtu kërkesën për hyrje-dalje e protokolluar nga organi kompetent.

2.3.16 Operatori ekonomik duhet të paraqesë projektin teknologjik të depove dhe linjave, të miratuara nga organet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi referuar VKM nr.970, data 2.12.2015.

2.3.17 Operatori ekonomik të disponoj minimum tre punonjës të certifikuar për ‘‘Mbrotjtjen nga zjarri dhe shpëtimi’’, të cilët të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi.

Për plotësimin e këtij kriteri të paraqitet kontrata e punës dhe certifikata e trajnimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nennt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Këto kritere janë vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, sidhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”, Urdhër Nr. 6, datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse, Urdhërit nr 315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitetet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”,

2.3.18 Operatori ekonomik duhet të pajisë me karta elektronike për identifikimin e mjetit dhe përdoruesit ekonomik të saj sipas kërkesës nga Autoriteti Kontraktor. Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesi një deklaratë me shkrim ku merr përsipër realizimin e kartave elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma ç,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte kerkuar qe operatori ekonomik te vetdeklaroje deklaratimet e mesiperme pasi AK kerkon garanci qe furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas VKM Nr 561 date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshme“, kartat do kene vlefshmeri edhe ne vitin 2023-2024, furnizimi me karburant do behet perne pistolete publike dhe sherbim 24 ore etj.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.